ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **250-25-3642-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Zhvillimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Buxhetit,Financave, Aseteve dhe Tiketave (Simbfat) për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Tretek SH.P.K.**
NUI	**810853821**
Adresa	**Rr.Astrit Rrushi Obj.Pika Mati 1**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38349642227**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Lirim Sylejmani**
Adresa elektronike	**lirim.sylejmani@tretek.io**
Data e parashtrimit të ankesës	**02.07.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontratë** – 14.05.2025
- **Procesverbali i hapjes** – 20.05.2025
- **Vendimi i AK-së** – 16.06.2025
- **Njoftimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim** – 23.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Jemi njoftuar përmes platformes elektronike te prokurimit publik me hapjen e tenderëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.
Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Bazuar në dispozitat e nenit 109(2) të LPP-së, parashtrojmë këtë **Ankesë** ndaj Vendimit të AK-së i pranuar nga OE me datën 16-06-2025 **("Vendimi i Ankimuar")** përmes së cilit është Refuzuar Kërkesa e datës 23-06-2025 në kuptim të së cilës është propozuar kthimi i tenderit në ri-vlerësim ashtu që pas rivlerësimit **Tretek SH.P.K.** si ofertues të përgjegjshëm dhe të na ftoj për nënshkrim të kontratës.

Në vijim, paraqesim qëndrimin tonë në lidhje me këtë çështje:

Pretendimet Ankimore

- Ne, kompania **Tretek SH.P.K.,** me seli në Prishtinë, kemi dorëzuar ofertën tonë brenda afatit dhe në përputhje me dokumentacionin përkatës të tenderit për projektin: **"Zhvillimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Buxhetit, Financave, Aseteve dhe Tiketave (Simbfat) për Këshillin Prokurorial të Kosovës"**, me numër të prokurimit: **250-25-3642-2 2**-1. Ofertën e kemi përgatitur në pajtim të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Pavarësisht kësaj, kemi pranuar një **vendim për refuzim**, pa qenë të njoftuar më parë për ndonjë mangësi formale apo teknike që do të mund të kërkonte sqarim ose përmirësim.

  Ju si OE nuk i ken plotësuar këto kritere , te Menaxheri i Projektit- Tek përvoja e punës, edhe pse ne CV shkruan se ka përvoje mbi 17 vjeqare, Vertetimi apo deshmi relevante ka bashkangjitur nje reference nga kompania Tretek, ku ne CV shkruan se punon nga muaji Shkurt 2025.
  Zhvillues Softueri- Tek pervoja e punes, Vertetimi apo deshmi relevante ka bashkangjitur nje reference nga kompania Tretek, ku ne CV shkruan se punon nga viti 2023.
  Si dhe eshte nderhyre tek TABELA A- Pjesa e Cmimve – Kategoria I – 40% , Tek sasia.

- Me datë **20.06.2025**, në përputhje me afatin ligjor ashtu siç parashohin dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, kemi ushtruar të drejtën tonë për **kërkesë për rishqyrtim**, duke kundërshtuar vendimin e AK-së **duke ofruar të gjitha dëshmitë dhe argumentet përkatëse**.

Po ashtu kemi theksuar se nëse ka pasur ndonjë paqartësi, AK-ja ka pasur detyrim ligjor sipas nenit **59.2 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik**, nenit **38 të Rregullores për Prokurimin Publik** që të kërkojë sqarime shtesë dhe jo të refuzojë ofertën pa dhënë mundësinë për qartësim. Kjo përbën shkelje procedurale dhe cenon të drejtën tonë për trajtim të barabartë në proces.

- Pavarësisht kësaj, më datë **23.06.2025** kemi pranuar **vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim**, në të cilin AK-ja konstaton se sa i përket stafit, ne i përmbushim plotësisht kërkesat e parashikuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. **Megjithatë, arsyeja e përjashtimit tonë nga procedura ka qenë pretendimi për ndërhyrje në Pjesën e Çmimeve, konkretisht në kolonën që përfshin sasinë.**

Pas pranimit të kërkeses për Rishqyrtim nga komisioni i vlersimit dejt të jetë se jus i OE e permbushni kërkesat sa i perket stafit të parapas në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit,Mirpa sa i perket nderhyrëjes në Pershkrim të çmimit kjo qështjëje është e rregulluar edhe me dispozita Ligjore dhe automatikisht eleminoheni. Pjesa e nderhyrëjes nga ana juaj është:

Nderhyre tek TABELA A- Pjesa e Cmimve - Kategoria I -40%, Tek sasia.

Sipas kësaj po del që i njejti ka modifikuar dhe ka ndërhyr në dokumentin zyrtar duke ndryshuar sasin dhe shënimet zyrtare tek Lista e Cmimit e cila është pjesë e përbërëse e Pjesës C (Formularit të tenderit) e që dosja e tenderit në strukturë përbëhet edhe nga Pjesa C.

Neni 32.8 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë:

[redacted]

"Tenderuesit shkarkojnë Formularin e Dorëzimit të Tenderit në kompjuterin e tyre dhe nëse është e aplikueshme e nënshkruajnë atë duke përdorur nënshkrimin(et) e tyre të avancuar digjital. Ofertuesit NUK DUHET të ndryshojnë apo modifikojnë përmbajtjen dhe strukturën e Formularit të Dorëzimit të Tenderit...".

- Në lidhje me pretendimin për "ndërhyrje" tek Tabela A – Pjesa e Çmimeve (tek kolona "Sasia"), sqarojmë se një veprim i tillë ka qenë rezultat i mospërputhjes mes Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME dhe strukturës së tabelës së çmimeve të dhënë nga AK-ja.

  Konkretisht, në Dosjen e Tenderit – pika 17 "Përkrahja & Mirëmbajtje " dhe 18 "Afatet Kohore të Projektit" – është përcaktuar qartë se periudha e mirëmbajtjes dhe përkrahjes duhet të zgjasë **29 muaj** pas pranimit të projektit.

Provë: Dosja e Tenderit

17. PËRKRAHJA (MBËSHTETJA) DHE MIRËMBAJTJA

Tabela 1. Kërkesat për përkrahje dhe mirëmbajtje

Përkrahja & Mirëmbajtje
1. a) Kontraktori DUHET të ofrojë mbështetje mbi përdorimin e sistemit në rast se 'super-users' ose administratorët nuk janë në gjendje të sqarojnë, zgjidhin një çështje ose shprehin nevojën për më shumë informacion/njohuri rreth sistemit. b) Kontraktori DUHET të riparojë të gjitha dështimet dhe mos-përputhjet e Softuerit gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe **29 muaj** pas Pranimit të Projektit. c) Të gjitha aktivitetet e shërbimit të riparimit të ofruara nga Kontraktori duhet të kryhen në përputhje me "Tabelën 2 – Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit – SLA" (shih më poshtë).
2.

Pika 17 e Dosjes së Tenderit

18. AFATET KOHORE TË PROJEKTIT

Tabela 3 tregon planifikim kohor të mundshëm të zbatimit të projektit, megjithatë, Kontraktori DUHET të propozojë orarin e vet në ofertë në përputhje me detyrën e projektit të listuar në këtë tabelë.
Përkrahja dhe mirëmbajtja do të jepet 12 muaj pas pranimit të projektit.

Tabela 3. Grafiku kohor i projektit

#	Aktiviteti/Muaji	1	2	3	4	5	6	7
1	Menaxhimi i Projektit dhe i Kontratës							
2	Analizimi, mbledhja dhe dokumentimi i kërkesave të detajuara të projektit							
3	Modele të detajuara të procesit të punës, proceset ndihmesë dhe kërkesat e Menaxhimit të Informacionit – Aprovimi i dizajnit							
4	Zhvillimi i Back-end, UI Dizajn & Front-end të softuerit							
5	Furnizimi/Dorëzimi i zgjidhjes së re të aplikacionit softuerik dhe çdo softuer shtesë (nëse aplikohet)							
6	Testimi i softuerit dhe trajnimi i përdoruesve							
7	Dokumentimi i projektit dhe pranimi i projektit							
8	Mirëmbajta dhe Përkrahja		**29 Muaj**					

Pika 18 e Dosjes së Tenderit

- Megjithatë, në **Tabelën A – Pjesa e Çmimeve**, sasia për mirëmbajtjen e sistemit është e paraqitur si **"1 muaj",** duke krijuar kështu një mospërputhje të qartë ndërmjet kërkesës teknike dhe formatit të çmimeve.

Provë: Formulari i çmimeve

Zhvillimi dhe implementimi i SISTEMIT ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E BUXHETIT, FINANCAVE, ASETEVE dhe TIKETAVE (SEMBFAT)

TABELA (A) - Pjesa I. LISTA E ÇMIMEVE - Kategoria I - 40%

Artikulli Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH €	TVSH %	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH €
1	Mirëmbajtja e sistemit	Muaj	1				
						TOTALI I PËRGJITHSHËM:	-

- Ne, si **Tretek SH.P.K.**, kemi vepruar saktësisht **sipas Dosjes së Tenderit (Aneksi 1)**, duke ndjekur strukturën ekzistuese të formularit të çmimeve, ashtu siç është publikuar nga Autoriteti Kontraktues. Kjo nuk përbën ndërhyrje në përmbajtjen apo strukturën e dokumentacionit të tenderit, por thjesht përputhje me formatin e dhënë dhe aneksi 1 të dosjes së tenderit.

ABELA (A) - Pjesa I. LISTA E ÇMIMEVE - Kategoria I - 40%

rtikulli Ir.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	n
1	Mirëmbajtja e sistemit	Muaj	29	

- Ne si **TRETEK**, konsiderojmë se vendimi i AK-së për të përjashtuar ofertën tonë për shkak të asaj që pretendohet si **"ndërhyrje në Formularin e Dorëzimit të Tenderit" <u>është i pabazuar</u>** dhe përbën **<u>interpretim të gabuar të dispozitave ligjore</u>**.
  Sepse paragrafi 32.8 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ndalon qartë çdo ndërhyrje në **Formularin e Dorëzimit të Tenderit**, dokument i cili shkarkohet në formë elektronike përmes sistemit të E-Prokurimit (me rastin e dorëzimit të ofertës). Në rastin tonë, nuk ka pasur asnjë ndryshim apo modifikim në këtë formular, i cili është dorëzuar në formën e gjeneruar nga sistemi, i paprekur dhe i nënshkruar në përputhje me kërkesat teknike.

  Provë: formulari i dorëzimit të tenderit

  Ndryshimi i pretenduar ka ndodhur në një dokument tjetër, përkatësisht **Listën e Çmimeve (Tabela A – Pjesa e Çmimeve)**, që nuk përbën as përmbajtje dhe as strukturë të **Formularit të Dorëzimit të Tenderit**.
  Ngatërrimi i këtyre dy dokumenteve ka çuar në një vendim të padrejtë dhe të pabazuar ligjërisht për përjashtimin e ofertës sonë, që përbën shkelje serioze të Ligjit të Prokurimit Publik.

Duke u bazuar në të gjitha shkeljet e lartpërmendura, **kërkojmë nga OSHP-ja që:**

I. **Ta shpallë ankesën tonë të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim**, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që, në përputhje Ligjin për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik, të anulojë vendimin e mëparshëm dhe të ftojë Tretek SH.P.K. për nënshkrimin e kontratës si operatori ekonomik me ofertën më të përgjegjshme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

Fitimet e pritura: Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
h) Dosja e tenderit
i) Formulari i çmimit
j) Formulari i dorëzimit të tenderit

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*